



Partia
Demokratike

KOALICIONI

PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Tiranë, më ____ Prill 2025

- Lënda:** KËRKESË
- Nga:** Z. Franci NURI, Përfaqësuesi Ligjor i Partisë Demokratike dhe i Koalicionit PD-ASHM në KQZ.
- Baza Ligjore:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Kodi Zgjedhor i RSH; Ligji për Partite Politike; Kodi i Procedurave Administrative;
- Drejtuar:** Z. ILIRJAN CELIBASHI, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).
- Për Dijeni:**
1. AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP)
 2. KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
 3. AGJENCIA KOMBËTARE PËR SHOQËRINË E INFORMACIONIT (AKSHI)
 4. AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE (AKSK)

I nderuar z. Komisioner,

Kjo kërkesë ka të bëjë me aspekte të dezinformimit dhe të (keq)përdorimit publik në Internet, Website, rrjetin META (Facebook, instagram etj) apo ne platforma te tjera online nga disa individë dhe 1 subjekt zgjedhor i regjistruar ne zgjedhjet e 11 Majit, të simboleve, logove apo emblemave dalluese / identifikuese, apo te ngjashme me ato tw Partisë Demokratike, simbole këto të cilat konfondojnë publikun dhe elektoratin, me simbolet tw cilat i përdor aktualisht edhe subjekti zgjedhor “**Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore**” – PD-ASHM, koalicion zgjedhor i regjistruar për zgjedhjet për Kuvend në 11 Maj, i cili udhëhiqet nga Partia Demokratike e Shqipërisë.


Konkretisht, **shqetësimi ynë vjen për keqpërdorimet vijuese**, (bashkëngjitur materiali i hollësishëm shoqësuar me pamjet dhe ilustrimet e rasteve konkrete në fjalë) :



1

1. Domaini <https://demokratet.al> ka qenë aset i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe është përdorur si domain kryesor gjatë fushatës elektorale të PD në zgjedhjet e viti 2017. Tashmë shërben si domaini kryesor i subjektit zgjedhor Koalicioni Euroatlantik. Në faqen zyrtare të këtij domaini shihet qartë përdorimi i logos së subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë. Gjithashtu, në nënfaqen “Kryetari” (<https://demokratet.al/kryetari/>), shfaqet një përmbajtje me titull: “Lulzim Basha, Kryetar i Partisë Demokratike”, kur ndërkohë personi Lulzim Basha nuk është kryetar i asnjë subjekti politik, e aq më shumë i Partisë Demokratike.

Ky screenshot është kapur më 02 prill 2025 në orën 18:46.



2. Faqja e Partisë Demokratike në Facebook

Faqja në Facebook me adresë: <https://www.facebook.com/demokratet.al> ka qenë faqja zyrtare e Partisë Demokratike të Shqipërisë. Historiku i kësaj faqeje daton që prej vitit 2009. Pas Gjyqit të Apelit, kësaj faqeje i është ndryshuar emri nga “Partia Demokratike e Shqipërisë” në “Partia Demokratike - Demokratët Euroatlantikë”, e më pas sërish në “Demokratët Euroatlantikë - Partia Demokratike”.

Kjo faqe “Demokratët Euroatlantikë - Partia Demokratike” është e verifikuar në Facebook dhe njihet nga ky i fundit si subjekti zyrtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë. Kjo faqe, gjithashtu, ka të lidhur domainin <https://pd.al> dhe çdo link i dalë nga ky domain është i asociuar me këtë faqe. Po ashtu, reklamat që mund të prodhojë kjo faqe janë të asociuara me subjektin Partia Demokratike e Shqipërisë, gjë që mund të përdoret për qëllime të këqija nga subjekti Koalicioni Euroatlantik. Kjo, gjithashtu, mund të kategorizohet si shpenzim i subjektit Partia Demokratike.

Momentalisht, subjekti Partia Demokratike po përdor faqen me adresë: <https://www.facebook.com/PartiaDemokratike>.

Ky screenshot është kapur më 02 prill 2025 në orën 18:55.

 2



3. Gjithashtu, faqja “Demokratët Euroatlantikë - Partia Demokratike” në Business Manager-in e Facebook-ut të vetë, ka të lidhur domainin <https://pd.al>.

Duke qenë se ky domain është i lidhur me një Business Manager, ku Partia Demokratike nuk ka askes, atëherë ky domain nuk mund të lidhet as me Business Manager-in që PD disponon aktualisht. [Shembulli i vendosur bashkëngjitur nw prova].

Si rrjedhojë e kësaj, çdo link i shpërndarë në platformat e Meta nga domaini pd.al, lidhet me faqen “Demokratët Euroatlantikë - Partia Demokratike”.

Përdorimi i këtyre simboleve në rrjetet sociale, në Internet, në Facebook, Instagram e më gjerë, nga individë apo subjekte të tjera zgjedhore, në fazën kur fushata zgjedhore zyrtare e 11 Majit nis për pak ditë, po dëmton interesat e ligjshme të subjektit tonë, duke krijuar konfuzion tek një pjesë e opinionit publik dhe elektoratit. Ndaj kerkojme që kjo kerkese te shqyrtohet me përparësi nga KQZ, maksimalisht deri ne hapjen e fushatës zgjedhore zyrtare.

Ndaj, po i drejtohem KQZ që të konstatojë këtë fakt dhe të merren masat e menjëhershme administrative dhe ligjore, për ndërprerjen e shkeljeve dhe cënimit të interesave të PD-ASHM nga çdo individ apo subjekt tjetër zgjedhor, përfshirë dorëzimin tek përfaqësuesit e PD e aksesit të llogarive / kredencialeve të PD që po keqpërdoren nga këtë individë apo subjekte zgjedhore.

Duke ju falenderuar,

**PËR KOALICIONIN “PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË
MADHËSHTORE - ASHM”**

Përfaqësuesi i Ligjor i Koalicionit në KQZ

z. Franci NURI

Memo: Problem me prezencën dixhitale të një subjekti politik


02.04.2025

1. Domaini [www.demokratet.al](https://demokratet.al)

Domaini <https://demokratet.al> ka qenë aset i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe është përdorur si domain kryesor gjatë fushatës elektorale të PD në zgjedhjet e viti 2017. Tashmë shërben si domaini kryesor i subjektit zgjedhor Koalicioni Euroatlantik.

Në faqen zyrtare të këtij domaini shihet qartë përdorimi i logos së subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë. Gjithashtu, në nënfaqen “Kryetari” (<https://demokratet.al/kryetari/>), shfaqet një përmbajtje me titull: “Lulzim Basha, Kryetar i Partisë Demokratike”, kur ndërkohë personi Lulzim Basha nuk është kryetar i asnjë subjekti politik, e aq më shumë i Partisë Demokratike.

Ky screenshot është kapur më 02 prill 2025 në orën 18:46.



2. Faqja e Partisë Demokratike në Facebook

Faqja në Facebook me adresë: <https://www.facebook.com/demokratet.al> ka qenë faqja zyrtare e Partisë Demokratike të Shqipërisë. Historiku i kësaj faqeje daton që prej vitit 2009. Pas Gjyqit të Apelit, kësaj faqeje i është ndryshuar emri nga "Partia Demokratike e Shqipërisë" në "Partia Demokratike - Demokratët Euroatlantikë", e më pas sërisht në "Demokratët Euroatlantikë - Partia Demokratike".

Kjo faqe "Demokratët Euroatlantikë - Partia Demokratike" është e verifikuar në Facebook dhe njihet nga ky i fundit si subjekti zyrtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë. Kjo faqe, gjithashtu, ka të lidhur domainin <https://pd.al> dhe çdo link i dalë nga ky domain është i asociuar me këtë faqe. Po ashtu, reklamat që mund të prodhojë kjo faqe janë të asociuara me subjektin Partia Demokratike e Shqipërisë, gjë që mund të përdoret për qëllime të këqija nga subjekti Koalicioni Euroatlantik. Kjo, gjithashtu, mund të kategorizohet si shpenzim i subjektit Partia Demokratike.

Momentalisht, subjekti Partia Demokratike po përdor faqen me adresë: <https://www.facebook.com/PartiaDemokratike>.

Ky screenshot është kapur më 02 prill 2025 në orën 18:55.



Gjithashtu, faqja "Demokratët Euroatlantikë - Partia Demokratike" në Business Manager-in e Facebook-it të vetë, ka të lidhur domainin <https://pd.al>. Duke qenë se ky domain është i lidhur me një Business Manager, ku Partia Demokratike nuk ka akses, atëherë ky domain nuk mund të lidhet as me Business Manager-in që PD disponon aktualisht.

Si rrjedhojë e kësaj, çdo link i shpërndarë në platformat e Meta nga domaini pd.al, lidhet me faqen "Demokratët Euroatlantikë - Partia Demokratike".

Për ta vizualizuar këtë problem, po paraqes një shembull:



3. Vërtetim nga gjykata


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË
ZYRA E REGJISTRIT TË PARTIVE POLITIKE
Tiranë më 11.12.2024

V Ë R T E T I M

Vërtetojmë se në Regjistrin e Partive Politike pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezultoi se me urdher nr. 12 datë 19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë është miratuar krijimi i Partisë "Partia Demokratike", me iniciais "PD" ose "PDSH".

Kryetar i Partisë është z. Sali Berisha.
E lëshojmë këtë vërtetim në përputhje të kërkesës së subjektit të interesuar.

SEKRETAR E REGJISTRIT TË PARTIVE POLITIKE

Besa KORBECI

